



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilazheni / Predato Received / Delivered	15-02-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOVSHCK	790/2022		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1208/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1208/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar avokati \_\_\_\_\_ përmes postës së Kosovës me datës 17.12.2021 me numër postar R 1922345, me adresë: për ankuesin \_\_\_\_\_ me adresë: \_\_\_\_\_ në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.1208/2021 të datës 21.12.2021 të ankuesit \_\_\_\_\_

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 21.12.2021 ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokoll 6251/2021 e regjistruar me numër rendor A.nr.1208/2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, me pretendime ankimore kundër Njoftimit të datës 18.11.2021 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP/MPB, për mos realizimin e pagës në pajtim me nenin 42 paragrafin 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik, me rastin e përfundimit të mandatit të tij, në pozitë: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, sipas Vendimit Nr. 34/39 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesë e datës 21.12.2021 me nr. protokoll 6251/2021 me numër rendor Anr.1208/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës; Autorizimi i avokatit \_\_\_\_\_ i datës 21.10.2021; Vendimi nr.16/35 i datës 09.03.2018; Vendimi Nr.34/39 i datës 13.10.2021 për shfuqizim të vendimit Nr.34/39 për vazhdim të mandatit; Vendimi Nr.13/59 i datës 21.01.2021 për vazhdim të mandatit; E-maili i datës 18.11.2021; E-maili i datës 10.11.2021; E-maili i datës 09.11.2021; E-maili i datës 07.11.2021; E-maili i datës 21.10.2021; Pliko postare e datës 17.12.2021 me numër postar R 1922345; Përgjigje në ankesë e datës 17.01.2022; Kërkesë e datës 13.01.2022; E-mail i datës 13.01.2022.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.1208/2021 të ankuesit të **pezullohet, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas ankesës me numër protokolli 6251/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, të datës 21.12.2021 ka shqyrtuar lëndën e ankuesit sipas ankesës së regjistruar me numër rendor A.nr.1208/2021, mirëpo për të njëjtin objekt shqyrtimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, është pranuar ankesa me numër Anr.67/2022 e datës 26.01.2022 nga ankuesi i njëjte kundër Zyrës së Kryeministrit, për çështjen juridike kundër Vendimit të Qeverisë me Nr.03/55 të datës 21.01.2022, që lidhet me pretendimet ankimore kundër Njoftimit të datës 18.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP/MPB, për mos realizimin e pagës në pajtim me nenin 42 paragrafin 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik, për të cilën çështje ankuesi është njoftuar dhe me E-mailin e datës 21.10.2021 nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, për zbatimin e Vendimit Nr.34/39 e datës 13.10.2021 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, i cili e ka shfuqizuar Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, duke dhënë arsyetimin e largimit nga paga sepse është caktuar zëvendësuesi në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë nga data 14.10.2021.

Meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, për të njëjtin çështje i ka pranuar dy ankesa nga ankuesi i njëjte, të cilat janë për çështjen juridike të njëjte, që lidhet me mandatin e ankuesit si dhe çështjen e mos realizimit të pagës në kuptim të nenit 42 paragrafin 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik, me rastin e shfuqizimit të Vendimit Nr.13/59 të datës 21.01.2021 për vazhdim të mandatit. Andaj lidhur me këtë çështje është vërtetuar se përderisa një lëndë është duke u trajtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, për të njëjtin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se në bazë të dispozitave ligjore të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”**, ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që shqyrtimi i lëndës A.nr.1208/2021 të pezullohet deri në vendosjen përfundimtare për lëndën me numër Anr.67/2022 nga Kolegji i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, sipas ankesës së datës 26.01.2022 të ankuesit, pasi që objekti dhe subjekti i shqyrtimit është i njëjtë dhe shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pasi që të vendos për rastin e ankuesit sipas ankesës me numër Anr.67/2022 të datës 26.01.2022, kundër Vendimit të Qeverisë me Nr.03/55 të datës 21.01.2022, që lidhet me pretendimet ankimore të lëndës me numër Anr.1208/2021 të datës 21.12.2021, kundër Njoftimit të datës 18.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP/MPB, për mos realizimin e pagës në pajtim me nenin 42 paragrafin 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik, me rastin e shfuqizimit të Vendimit Nr.13/59 të datës 21.01.2021 për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, Kolegji i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës do të vendos edhe për lëndën me numër A.nr.1208/2021 të datës 21.12.2022 për ankuesin

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.1208/2021**

**Zyle Millaku Gojnovci**

*Zyrtarë e Kartë për Bashkëpunim Profesional*

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshmes;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

**Malsore Gashi BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*